Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË KONFERENCËN "TRASHËGIMIA ZGJEDHORE EVROPIANE: DHJETË VJET TË KODIT TË PRAKTIKAVE TË MIRA NË ÇËSHTJET ZGJEDHORE "

2 korrik 2012

Zonja Kryetare,
I nderuar Profesor Velaers,
Kryetar Ristani,
Shkëlqesi,
Zonja dhe zotërinj,
Mirëdita!

Marrja e fjalës në emër të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri në hapjen e kësaj konference me vend e të përshtatshme në kohë për të shënuar 10-vjetorin e *Kodit të Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore* më mbush me kënaqësi të madhe profesionale.

Përgëzoj autoritetet shqiptare dhe Komisionin e Venecias të Këshillit të Evropës, që po e organizojnë një veprimtari kaq të rëndësishme këtu në Tiranë.

Më lejoni të dal drejt e në temë:

Zgjedhjet e lira e të ndershme i japin çdo shoqërie moderne demokratike legjitimitetin themelor.

Përmes pjesëmarrjes së tyre fizike në Ditën e Zgjedhjeve, votuesit janë të lirë të shprehin vullnetin e tyre politik se kush duhet t'i përfaqësojë dhe kush duhet të miratojë ligje e t'i kërkojë llogari qeverisë së radhës.

Në Evropën e 2012-ës, zhvillimi siç duhet i zgjedhjeve përbën qartësisht një standard kyç të legjitimitetit demokratik dhe nivelit të progresit kombëtar të një vendi.

Investimi për mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme është edhe një investim për stabilitetin politik dhe paqen sociale të një vendi.

Fusha e zgjedhjeve mbetet një fushë e rëndësishme partneriteti midis OSBE-së dhe Këshillit të Evropës.

Në fakt, një partneritet që Kryesia shqiptare e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës aspiron ta rrisë më tej.

Këshilli i Evropës, përmes Komisionit të Venecias, dhe OSBE/ODIHR-i kanë një traditë të gjatë dhe krenare bashkëpunimi të ngushtë, e cila kombinon asistencën zgjedhore me vëzhgimin e zgjedhjeve.

Siç e dimë, Opinionet e tyre të Përbashkëta për pjesë specifike të legjislacioneve vendase për zgjedhjet kanë ndihmuar shumë vende të hartojnë dhe të zbatojnë ligjet e tyre zgjedhore në

përputhje me parimet e përcaktuara në Kodin e Praktikave të Mira të Komisionit të Venecias për Çështjet Zgjedhore dhe në Dokumentin e Kopenhagenit të OSBE-së.

Në këtë pikëpamje, Kodi, i miratuar nga Komisioni i Venecias në vitin 2002, përbën një dokument strategjik kyç në njohjen e zgjedhjeve universale, të barabarta, të lira, të fshehta, të drejtpërdrejta dhe periodike si veçoritë kryesore për të gjitha demokracitë e pjekura moderne.

Kodi ka ndihmuar suksesshëm harmonizimin e ligjeve zgjedhore të vendeve me standardet ndërkombëtare dhe në përcaktimin e procedurave më të mira për administrimin e zgjedhjeve.

Kjo më sjell te çështja e reformës së Kodit Zgjedhor në Shqipëri, ku OSBE-ja, Prezenca në Shqipëri, i ka mëshuar me forcë përmbushjes së plotë të të gjitha standardeve zgjedhore ndërkombëtare.

Është e rëndësishme të thuhet se deri tani është bërë një punë e madhe nga Kuvendi i Shqipërisë.

Vija e finishit është afër – por vetëm për ata me vullnet politik.

Megjithatë, çdo reformë e miratuar në fund duhet të kërkojë konsensusin më të gjerë të mundshëm dhe duhet të jetë në gjendje t’i rezistojë sprovave të kohës.

Një rezultat i suksesshëm i reformës, i cili duhet pasuar nga një zbatim i plotë dhe i ndershëm i ligjit të ri zgjedhor, do të përbënte një kontribut të prekshëm në axhendën e reformave të vazhdueshme të Shqipërisë dhe në aspiratat e saj ndërkombëtare afatgjata.

Mendoj se duhet të them, gjithashtu, se një përfundim në kohë i reformës nevojitet edhe që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të ketë kohë të mjaftueshme për të bërë përgatitjet e duhura në mënyrë të efektshme.

Përmbushja e kësaj detyre kërkon, mbi të gjitha, që udhëheqësit politikë t'i lënë mënjanë interesat partiake vetjake dhe të vënë në plan të parë vendin e të nderojnë besimin që u kanë dhënë qytetarët shqiptarë.

Në këtë drejtim, mendoj se nuk kemi ç't'i shtojmë rekomandimit të parë të OSBE/ODIHR-it në dy raportet Raporteve Përfundimtare të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të viteve 2009 dhe 2011:

Citoj: “Partitë politike duhet të tregojnë vullnet politik për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike që u korrespondon privilegjeve të mëdha që gëzojnë sipas ligjit në lidhje me zhvillimin e zgjedhjeve. Ato duhet të përmbushin detyrat e tyre zgjedhore në mënyrë të përgjegjshme në interesin e përgjithshëm të Shqipërisë”.

Na mbetet ende të shohim nëse udhëheqësit politikë të këtij vendi do të udhëhiqen nga një ndjenjë më e lartë përgjegjësie kundrejt qytetarëve dhe mirëqenies së tërë vendit.

Sa gjatë mund të presë Shqipëria?

Unë jam i bindur se qytetarët e këtij vendi janë në gjendje t’i japin përgjigje kësaj pyetjeje.

Në demokracitë e pjekura, shoqëria civile, përfshirë median, kontribuon në sistemin e krijimit të opinioneve, që çojnë drejt zhvillimeve dhe përfundimeve të rëndësishme, duke kontribuar kështu në funksionimin e sistemit kontrollues të *checks and balances*.

Institucionet e këtij vendi sovran duhet të jenë të përgjegjshme.

Përgjegjësia duhet të karakterizojë vullnetin politik dhe gjykimet e shëndosha të udhëheqësve të tij politikë.

Përgjegjësia duhet të jetë e pranishme edhe në shoqërinë civile, e cila duhet të luajë rolin e saj të plotë në çuarjen përpara të ndryshimit.

Zonja Kryetare,
Profesor Velaers,
Kryetar Ristani,
Zonja dhe zotërinj,

Lejoméni të mbyll fjalën time, duke i përgëzuar sërish organizatorët e kësaj veprimtarie dhe lejoméni të përsëris, po ashtu, se Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mbetet e përkushtuar, së bashku me partnerët e saj ndërkombëtarë, për të ndihmuar autoritetet shqiptare në rrugën e reformës.

U uroj të gjithë pjesëmarrësve një konferencë të suksesshme.

Ju faleminderit!

Fund